

REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARIMIT PRIVAT  
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT ELVIN HOXHA  
CERTIFIKATE NR.206/JANAR 2015 NIPT.L42109004H  
Adresa: Rruga "Vaso Pasha" Nr.13/1, Ap.1, Tirane  
E-mail: [elvinth@hotmail.com](mailto:elvinth@hotmail.com) Mob: +355682029920

Nr.87/2016  
Nr. 1787 Prot.

Tiranë më datë. 8/11/2016

URDHËR

(PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)

Drejtuar : QËNDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT

Per Dijeni : Debitorit , Shoqëria "Apoll Net" sh.p.k , Nr.Nipt L22723402J  
Kreditorit, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)

Prane zyres se Permbaruesit Gjyqesor Privat Elvin Hoxha eshte depozituar kerkesa e pales kreditore Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) sëbashku me Vendimit për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 1874(31100-07956-80-2015) datë 18.12.2015 të lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me palë:

**Kreditor: Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)**

**-Debitor: Shoqëria "Apoll Net" sh.p.k , Nr.Nipt L22723402J**

**-Objekti:** Lëshimi i Urdhërit të Ekzekutimit për sanksionin me gjobë Nr.29 datë 02.09.2015 të Grupit të Inspektimit të AMA-s , të vendosur ndaj shoqërisë "Apoll Net" për subjektin kabllor "Tv Apollnet

Me Vendimin për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 1874(31100-07956-80-2015) datë 18.12.2015 të lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, është vendosur:

- 1- Pranimi i kërkesës së Kerkuesit **Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)**
- 2-Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv gjobë Nr.29 datë 02.09.2015 të Grupit të Inspektimit të AMA-s.
- 3- Urdhërohen Zyrat e Përmbarimit për ekzekutimin e këtij vendimi.

Referuar Vendimit te Gjobes me nr. 29, datë 02.09.2015, sanksionon subjektin e sipërpermendur me masën **2.000,000 (dy milion ) Lekë**

Ne kushtet kur per ekzekutimin e Vendimin për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 1874(31100-07956-80-2015) datë 18.12.2015 të lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, nuk është permbushur detyrimi ne menyre vullnetare , nga ana e Permbaruesit Gjyqesor Privat duhet te kryhet vendosja e mases se sekuestros konservative ne kuotat/aksionet e pales debitore Shoqëria "Apoll Net" sh.p.k , Nr.Nipt L22723402J



Si në zbatim të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile dhe ligjit nr.10031 , datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat”

**URDHEROJ :**

1-Vendosjen e mases se sekuestros konservative ne kuotat/aksionet e pales debitore Shoqëria “Apoll Net” sh.p.k , si dhe mbi te drejtat qe rrjedhin nga zoterimi i ketyre kuotave duke ndaluar tjetersimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnje veprimi tjetër i cili mund te ndryshoje te dhenat ne regjistrin tregtar. Dokumentacioni do te qendroje i bllokuar deri ne nje urdher te dyte nga Permbartuesi Gjyqësor Elvin Hoxha .

**Shoqëria “Apoll Net” sh.p.k , Nr.Nipt L22723402J me adrese te ushtrimit te aktivitetit :  
Lagjia “Apollon”, Sheshi “Fitorja” , godina pranë foto Rustemi , Fier**


2- Per veprimet apo mos veprimet tuaja duhet te na vini ne dijeni shkreserisht brenda afatit ligjor


3- Personat qe behen pengese , do te pergjigjen ne baze te nenit 606 K.Pr.Civile (paragrafi II) qe parashikon vendosjen e sanksionit te gjobes dhe kallezimit penal.

4- Ky urdher mbahet ne disa kopje dhe u njoftohet paleve te cilat kan te drejten e ankimit ne Gjykate brenda 5 (pese) diteve.

**PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT**

**ELVIN HOXHA**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË**  
**TIRANË**

Nr. Regj. Them.1874 (31100- 07956 -80-2015)

Dt .rregj. Them 09.12.2015

Dt . 18.12.1015

**V E N D I M**  
**“NE EMER TE REPUBLIKES”**

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare, Tirane, e perbere nga:

**Gentian Medja – Gjyqtar**

Asistuar nga sekretare seance Orgesa Mucaj, me date 18.12.2015, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore me dyer te hapura ceshtjen me nr.regj.them. 1874 (7956), dt.09.12.2015, qe i perket:

**KERKUES:** Autoriteti i Mediave Audiovizive.

**OBJEKTI:** Leshimi i Urdherit te ekzekutimit per sanksionin me gjobe nr.29 dt.02.09.2015 te Grupit te Inspektimit te AMA-s, te vendosur ndaj shoqerise “ Apoll Net “ per subjektin kabllor “TV Apollnet”.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 510, 511 e vijues te K.Pr.Civile. Ligji nr.49/2012.

Gjykata pasi shqyrtoi ne teresi kete kerkese

**VEREN se**

Autoriteti i Mediave Audiovizive i eshte drejtuar Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane, me kerkese per leshimin e urdherit te ekzekutimit per sanksionin me gjobe nr.29 dt.02.09.2015 te Grupit te Inspektimit te AMA-s, te vendosur ndaj shoqerise “ Apoll Net “ per subjektin kabllor “TV Apollnet”.

Nga shqyrtimi gjyqesor rezulton se me gjoben nr.29, dt.02.09.2015, grupi I Inspektimit te AMA-s kane vendosur per te denuar me gjobe shoqerine “ Apoll Net “ per subjektin kabllor “TV Apollnet”, per kundervajtje te parashikuar ne nenin 133 pika 13 te ligjit nr.97/2013.

Në zbatim të nenit 133/13 te ligjit nr.97/2013 dhe nenit 24 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, gjobat e vendosura nga pala kerkuese përbëjnë titull ekzekutiv.

Në këto kushte, meqenese akti administrativ përbën titull ekzekutiv, gjykata cmon se duhet të leshohet udhëri i ekzekutimit për fletë gjyben nr.29, dt.02.09.2015 të Grupit të Inspektimit të AMA-s.

### PER KETO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenin 511 të K.Pr.Civile

### VENDOSI

- Pranimin e kërkesës.
- Leshimin e urdherit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv, gjybe nr.29, dt.02.09.2015 të Grupit të Inspektimit të AMA-s.
- Urdhërohen Zyrat e Permbarimit për ekzekutimin e këtij vendimi.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kerkuesit.
- Një kopje e këtij vendimi ti njoftohet Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Tirane, më 18.12.2015.

**Sekretare**  
**Orgesa Mucaj**



**Gjyqtar**  
**Gentian Medja**

